

V E N D I M
Nr.511, datë 26.10.1993

**PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES BRENDA VENDIT TË DISA LËNDËVE TË
PARA, MATERIALEVE, PJESËVE TË NDËRTIMIT, MAKINERIVE ETJ., TË ARDHURA
NË KUADRI E NDIHMAVE DHE KREDIVE ME KUSHTE FAVORIZUESE NGA
INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE E SHTETE TË VEÇANTA, SI DHE PËR
MENYRËN E PAGESËS SË TYRE**

Për të përcjellë deri te ndërmarrjet përdoruese një pjesë të lehtësive që sigurohen nga ndihmat e kreditë me kushte favorizuese të institucioneve ndërkombëtare ose shteteve të veçanta, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Për çmimet

1. Çmimet e shitjes brenda vendit për lëndët e para, materialet, pjesët e ndërrimit, pajisjet, makineritë etj. të importit që janë siguruar nga ndihmat dhe kreditë me kushte lehtësuese të institucioneve ndërkombëtare e shteteve të veçanta, formohen nga çmimet CIF (kthyer në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë në ditën e lidhjes së kontratës me jashtë) plus taksat sipas ligjeve në fuqi dhe shpenzimet e tjera brenda vendit.

2. Për lëndët e para, materialet, pjesët e ndërrimit të mbërritura, por të pa shpërndara (shitura), gjendje në magazinat qendrore ose ato të ndërmarrjeve, për shkak të çmimeve relativisht të larta, ministrinë mund të propozojnë për miratim në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë ulje të çmimit CIF deri në masën 30 për qind të tij.

Në rast se edhe pas uljes së çmimeve si më sipër një pjesë e mallrave mbeten ende të pashitshme, strukturat që i disponojnë ato, të organizojnë sipas rregullave në fuqi ankande të hapura për realizimin e shitjeve të tyre.

3. Uljet e çmimeve sipas pikës 2 të zbatohen vetëm për lëndët e para, materialet, pjesët e ndërrimit, të financuara nga ndihmat dhe kreditë në proces, të lidhura para datës së daljes së këtij vendimi.

4. Për makineritë dhe pajisjet me cikël relativisht të gjatë përdorimi nuk do të zbatohen ulje të çmimeve, por përdoruesit e tyre të lehtësohen (favorizohen) në drejtim të zgjatjes së afatit të pagesave me këste vjetore në formën e kredisë mall.

II. Për mënyrën e pagesës së mallrave brenda vendit.

1. Për të gjitha mallrat që sigurohen nga ndihmat ose kreditë në proces, përdoruesit brenda vendit furnizohen kundrejt pagesës sipas çmimeve të përcaktuara në kreun I të këtij vendimi.

2. Paga për mallrat e mësipërme nga përdoruesit mund të bëhet:

a) e menjëhershme;

b) me këste në formën e kredisë mall.

Për përdoruesit që nuk kanë aftësi paguese të menjëhershme, të zbatohen pagesa me këste vjetore në formën e kredisë mall, të cilat të disiplinohen me marrëveshje të veçanta ndërmjet tyre dhe ministrive, si komponente të ndihmës ose kredisë, nëpërmjet sistemit financiar-bankar.

3. Si rregull, kredia mall i jepet përdoruesit për jo më shumë se 2 vjet për lëndët e para, materialet, pjesët e ndërrimit dhe për jo më shumë se 10 vjet për makineritë e pajisjet me cikël më të gjatë përdorimi.

4. Kredia mall të jepet me interesa jo më shumë se 2.5 për qind në vit për mallrat që parashikohet të shlyhen për jo më shumë se 5 vjet dhe me interesa jo më shumë se 5 për qind për mallrat që parashikohet të shlyhen nga 5-10 vjet. Llogaria e interesit të bëhet duke u bazuar në çmimin fillestar të çdo malli në valutë, kthyer në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë në ditën e pagesës së çdo kësti.

5. Paga e kredisë mall bëhet me këste të barabarta vjetore, Kësti i parë të paguhet në momentin e blerjes së mallit dhe këstet e tjera në formë parapagimi, por jo më vonë se një muaj nga data e pagesës së parë në vitin e parë. Nga ky rregull bëjnë përjashtim kreditë mall të akorduara deri në datën e daljes së këtij vendimi.

6. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore që përfshihen në ndihma e kredi të kësaj natyre, të paraqesin për miratim në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë propozimet përkatëse për afatet e pagesave për mallrat që do të blenë ndërmarrjet e sistemit të tyre, si dhe normat e interesit në varësi nga lloji, sasia e tyre dhe mënyra e përdoruesve.

7. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të përgatitë udhëzimin dhe rregullat përkatëse për skemën financiare dhe mënyrën e kryerjes së pagesave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi